## KONTRATE SHITBLERJES SE PJESEVE TE KAPITALIT

Në cilësinë e **Shitësit** : **ARBEN DOKO**, atësia Sami, i dtl. 26.09.1963, lindur dhe banues në Elbasan me adresen Lagja Dyli HaxhireMyzyri,Nr.821, Hyrja-1 me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit nr. 027872585, personal nr. **G30926108G**.
***Jep pëlqimin*** *për lidhjen e kësaj kontrate bashkëshortja e shitësit*, zj. **ANILA DOKO**, atësia Fatmir, e dtl. 10.04.1971, lindur në Korçë, banuese në Elbasan, me zotësi të plotë për të kryer veprime juridike, pajisur me letërnjoftim nr. 027872449, personal nr. **H15410337O**.

Në cilësinë e **Blerësit** : **FATBARDH DOKO**, atësia Sami, i dtl. 30.06.1959, lindur në Fier, banues në Elbasan ne adresen Lagja Dyli HaxhireMyzyri,Nr.821, Hyrja-2, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit nr. 027989898, personal nr. **F90630170H**.

### NENI 1
### KUSHTET PARAPRAKE

Kushtet paraprake te mesiperme jane pjese thelbesore dhe integruese e kesaj kontrate.

### NENI 2
### SHITJA E KUOTES

2.1 Shitesi z.Arben Doko,deklaron se eshte ortake dhe zoterues i 50% te kapitalit te shoqerise "Doko " shpk me 1(nje) kuote per vleren 301.861.037.50 leke, e cila eshte nje shoqeri tregtare shqiptare e regjistruar prane QKR me NIPT J62903324K dhe ka seline ne adresen Bradashesh, prane Kombinantit Siderurgjik, Elbasan.Nepermjet kesaj kontrate Shitesi i shet dhe i transferon Bleresit dhe ky i fundit pranon dhe blen kuoten me vleren nominale 301,861,037.50( treqinde e njemilion e teteqinde e gjashtedhjete e nje mije e tridhjete e shtate pike pese )leke, kjo ne perputhje me kushtet dhe afatet e percaktuara ne kete kontrate.

2.2 Titulli i pronesise mbi kuoten do te transferohet prej Shitesit tek Bleresi menjehere me nenshkrimin e kesaj kontrate.

2.3 Cmimi i kontartes eshte per vleren 3.833.627.50(tremilione e teteqinde e tridhjete e tremije e gjashteqinde e njezete e shtate pike pese) leke, ose vlera e kapitalit fillestar te investuar nga vete Shitesi,pagesa e ketij cmimi do te dokumentohet me levizjen e llogarise bankare, midis paleve.

### NENI 3
### DEKLARIME DHE GARANCI TE SHITESIT

3.1 Shitesi deklaron dhe garanton se eshte i vetmi pronar dhe titullar i kuotes dhe i te drejtave qe rrjedhin prej saj.

3.2 Shitesi deklaron dhe garanton se kuotat jane teresishte te lira nga cdo peng,privilegj,barre siguruese,detyrim,garanci apo cdo e drejte tjeter ne favor te te treteve.

SH.P.K. DOKO ELBASAN ALBANIA

## NENI 4
## TE TJERA

4.1 Te gjitha njoftimet,kerkesat dhe komunikimet ndermjet Paleve duhet te behen me shkrim dhe te dorzohen prane selise se regjistruar te Bleresit dhe te Shitesit,njoftimet do te jene me leter rekomande dhe kthim pergjigje.

4.2 Shitesi deklaron se pamvarsishte cmimit te blerjes ne marveshje mes paleve ,pasketej nuk ka asnje pergjegjesi apo detyrim per kredite,borxhet dhe situaten financiare te shoqerise dhe nuk gezon asnje te drejte lidhur me kuoten qe transferohet me shitje,ne cilesine e ortakut.

4.3 Bleresi perfitues i kuotes pamvarsishte cmimit te blerjes ne marveshje mes paleve, bazuar ne ligje pergjigjet pasketej personalisht per cdo veprim lidhur me kuoten ne fjale dhe vleren totale te kapitalin nominal te shoqerise.

## NENI 5
## ZGJIDHJA E MOSMARVESHJES

Palet angazhohen te zgjidhin me mirkuptim cdo mosmarveshje qe lidhet me interpretimin dhe ekzekutimin e kesaj kontrate dhe vetem kur nje zgjidhje e tille nuk eshte e mundur mosmarveshja do te kaloj per zgjidhje ne Gjykaten e Rrethit Gjyqesor Elbasan.

## NENI 6
## E DREJTA E ZBATUESHME

Kjo kontrate do te rregullohet ne baze te se drejtes shqiptare ne fuqi.

## NENI 7
## VLEFSHMERIA-ORIGJINALET

Kjo kontrate u hartua ne kater ekzemplare me vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe palet deklaruan se jane dakort me sa me siper, dhe pasi e lexuan, e kuptuan, e nenshkruan regullisht me date 14.Shkurt.2017.

**SHITESI**

Asbem Doko

SH.P.K. DOKO ELBASAN-ALBANIA

**BLERESI**

Fatbardh Doko

Jep pelqimin bashkshortja e Shitesit

Anila Doko